

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 15 SHTATOR 2022

Zonja deputete, zotërinj deputetë,

Të dashur qytetarë dhe qytetare që ndiqni këtë seancë parlamentare,

Zonja drejtuese e seancës,

Kryetare e Parlamentit.

Shfrytëzoj këtë rast për t'i shprehur mirënjohje të thellë dhe të pakufishme Komisionit Europian dhe vendeve anëtare për ndihmën e jashtëzakonshme në këto dekada, më të madhe se çdo institucion tjetër, dhënë shqiptarëve në rrugën e ndërtimit të demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Mirënjohja e pakufishme shkon për taksapaguesit e vendeve anëtare, pasi çdo qindarkë e tyre është mund dhe djersë e këtyre taksapaguesve.

Sigurisht që ne do ta miratojmë këtë marrëveshje me mirënjohje, por e ftoj Komisionin Europian dhe i kërkoj atij të kushtëzojë përfundimisht çdo qindarkë të tij derisa kjo qeveri të jetë me kushtet që vijojnë: Së pari, të kushtëzojë disbursimin e ndihmave me detyrimin e Shqipërisë për të përdorur standardet europiane në prokurimet publike, në koncesione dhe në partneritetin publik-privat; të kushtëzojë ndalimin në Shqipëri në mënyrë përfundimtare të tenderëve sekretë që janë rritur 20 herë; të kushtëzojë detyrimin e kësaj qeverie, që vjedh nga mëngjesi deri në darkë, të përdorë manualin e BE-së për ndërtimet publike, sepse sot ç'po ndodh?! Është e vërtetë që ju po jepni dhe po kontrolloni, në një farë mënyre, implementimin e projekteve tuaja, por me projekte të tjera, dhjetëra herë më të mëdha, kjo qeveri po vjedh qytetarët shqiptarë.

Ndaj, të marrin fund tenderët sekretë! Imponojini qeverisë shqiptarë të përdorë manualin e ndërtimit të BEsë, sepse Shqipëria është vendi me kostot më të larta në planet të ndërtimeve publike. Një shkollë në Tiranë, e cila ndërtohet sipas manualëve të BEsë apo manualëve të

Shteteve të Bashkuara dhe që mbikëqyret nga UNDP-ja kushton 680 mijë euro, ndërsa shkolla tjetër, e cila ndërtohet me manuale të Edi Ramës, kushton 4,2-5,2 milionë euro. Prandaj, është koha, ju lutem të mbikëqyrni jo vetëm paratë e taksapaguesve tuaj, por të mbikëqyrni, me një dhembshuri dhe ndjeshmëri, se çfarë ndodh me paratë e taksapaguesve shqiptarë. Është koha të ndalemi, sepse një kilometër rrugë të ndërtuar nga bankat e Europës apo Komisioni European realizohet me 2 deri në 3 milionë euro, ndërsa me manualin e kësaj qeverie, që vjedh nga mëngjesi deri në darkë, 1 kilometër realizohet me 22 milionë euro.

Unë i bëj thirrje Bashkimit European dhe Komisionit European të mos disbursojë asnjë qindarkë në qoftë se nuk bëhet hetimi i plotë, transparentë dhe të vendosen para ligjit Edi Rama, Ëngjëll Agaçi, Arben Ahmetaj dhe Erion Veliaj për aferën e tmerrshme të djegësve, në të cilën janë vjedhur qindra miliona euro. Janë tre djegës, dy nuk ekzistojnë fare dhe tjetri është jashtë funksionit, të cilët janë prokuruar në kundërshtim me ligjet e vendit me negociata të mbyllura, pa garë dhe me bonuse 8 %, të dhëna kompanisë qeveritare me emrat: Zoto, Gugallja e të tjerë.

Unë i bëj thirrje Komisionit European të mbajë qëndrimin më të rreptë dhe të mos disbursojë asnjë qindarkë pa kontrolluar aferën e tmerrshme multimiliardëshe të portit të Durrësit, që tani, së fundi, del se përfitues përfundimtar nuk është më Emar por, është dikush i afërt i Vuçiqit. I bëj thirrje Komisionit, sepse porti i Durrësit është porti i shpallur nga sekretariati i transportit të Bashkimit European si port strategjik. Edi Rama me këta ministra dhe ministre do të ndërtojnë Dubain e tyre. Vetëm toka kushton 3 miliardë euro dhe ndërtimi është i llogaritur 4 miliardë euro. Gjithçka është bërë pa garë dhe pa asnjë konsultë. Ju lutem, kini mëshirë për taksat e qytetarëve shqiptarë dhe për taksat e qytetarëve europianë!

Po shtoj, gjithashtu, se paratë e taksapaguesve europianë janë përdorur në aferën e djegësve. Kërkoj kujdesin më të madh, njerëzisht, i kërkoj Komisionit European të mos disbursojë asnjë qindarkë pa hetuar plotësisht aferën e Butrintit, e cila është një aferë gjigande korrupsioni. Kjo është shpërbërja e një prej parqeve më të çmuara të Shqipërisë, të rajonit dhe Europës kryekëput mbi bazën e korrupsionit. U bëj thirrje Parlamentit European dhe Kongresit të Shteteve të Bashkuara të ndërmarrin një hetim të plotë për këto afere të mëdha. Shqipëria ka tejkaluar çdo lloj limiti dhe çdo lloj linje të kuqe për sa i përket vjedhjes dhe korrupsionit. Thirrja

ime për Komisionin European është një hetim për monumentet e korrupsionit në Tiranë dhe për kullat e drogës, për shqiptarët europeanë kam një të dhënë zyrtare.

Indeksi i ndërtimeve në Shqipëri është mesatarisht 3 herë më i lartë se në çdo vend të Bashkimit European. Çmimet në Shqipëri jo që s'janë ulur, por qëndrojnë në vendin e tretë, më të lartat në Europë. Droga, lumenjtë e drogës po e rrënojnë këtë vend. Instituti i Statistikave të kësaj qeveria njofton se vitin e kaluar çmimet u rritën me 3,9%. Kjo është narkorritje klasike, sepse punësimi u rrit vetëm 0,5%. Pra, çfarë janë këto kulla?! Këta janë mullarët gjigandë të drogës të Edi Ramës. I bëj thirrje Komisionit European të hetojë në të gjitha anët, sepse Tirana zien dhe gumëzhin se në kulla është bashkëpronar Edi Rama dhe, siç thotë populli shqiptar: “Ku ka zë s'është pa gjë”.

Ka shumë eksponentë të tjerë që mund t'u përmenden emrat, por të gjithë tregojnë me gisht Edi Ramën. Një hetim ndërkombëtar do të ishte një ndihmë jashtëzakonisht e çmuar për shqiptarët. Edhe një herë, përulem me nderim të madh përpara bujarisë së Komisionit European dhe taksapaguesve europeanë, por, njerëzisht, u kërkohet të kushtëzojnë çdo qindarkë me disa kushte për të mbrojtur taksapaguesit shqiptarë nga një klikë që po i vjedh natën, ditën, në festa, në gëzime, në hidhërime, në çdo gjë, në çdo akt, në çdo vendim dhe në çdo firmë.